



**Raport Përfundimtar për Auditimin Tematik të ushtruar në
Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Sarandë**

**Raport Përfundimtar Auditimi
Tematik**

PRILL 2021



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI TEMATIK "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA" NË
DVASHK SARANDË

PËRMBAJTJA		
I.	Përmbledhje Ekzekutive	1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit 2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve 3. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit
II.	Hyrja	1. Objektivi i Auditimit 2. Qëllimi i Auditimit 3. Identifikimi i çështjes 4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese 5. Përgjegjësitë e audituesve 6. Kriteret e Vlerësimit 7. Standartet e auditimit 8. Metodatat e auditimit 9. Dokumentimi i auditimit
III	Përshkrimi i auditimit	11-27
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	11
2	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	11-27
2.1	Hartimi i programit (plani i veprimit). Respektimi i afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjit nr. 154/2014, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".	11-13
2.2	Zbatimi i rekomandimeve për përmirësime në legjislacionin në fuqi. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar.	13
2.3	Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar.	13-25
2.4	Zbatimi i rekomandimeve për shpërblimin e dëmit ekonomik. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar.	25-26
2.5	Zbatimi i rekomandimeve për përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar.	26-27
2.6	Zbatimi i rekomandimeve për masa disiplinore dhe administrative. Fillimi i procedurave për dhënien e masave disiplinore dhe administrative. Sa rekomandime janë pranuar dhe ecuria e tyre për masat e dhëna.	27
IV.	Konkluzioni i Auditimit	27
V.	Gjetje dhe Rekomandime	28-31
VI.	Lista e dokumenteve të auditimit	31



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI TEMATIK “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA” NË
DVASHK SARANDË

I. Përmbledhje Ekzekutive

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit (në vijim KLSH) ushtroi auditimin tematik me objekt “Mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2020” në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (në vijim DVASHK) Sarandë, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me verifikimin dhe vlerësimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, përcjellë me shkresën nr. 902/8, datë 22.05.2020.

Gjatë auditimit në terren nga grupi i auditimit është mbajtur 1 akt-konstatim, sipas çështjeve respektive, i cili është dorëzuar në protokollin e subjektit. Në përfundim të punës në terren është kryer takimi përmbyllës me përfaqësuesit e DVASHK Sarandë.

I.2. Në mënyrë të përmbledhur gjetjet dhe rekomandimet më të rëndësishme të auditimit, paraqiten si më poshtë vijon:

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJA E GJETJES	FAQE	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1.	Gjetje: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së me shkresën përcjellëse nr. 902/8 prot., datë 22.05.2020, nuk janë zbatuar plotësisht rekomandimet si vijon: <u>A. Masa Organizative</u> Rekomandim nr.1.1: Drejtoria Vendore e ASHK Sarandë, për nevoja të plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor të objekteve me leje legalizimit të lëshuara, t'i kërkojë Bashkive Sarandë, Himarë, Finiq dhe Konispol, vërtetimet mbi llogaritjen dhe pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën prej 804,249,039 lekë, si dhe të kërkojë që të bëhet regjistrimi në sektorin përkatës të kartelës në Drejtorinë Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Sarandë, në refuzim të vendosen masë për kufizimin deri në arkëtimin e plotë të detyrimeve të papaguara. Rekomandim nr.5.1: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Sarandë: 1. Në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK Tiranë, për objektet informale të pajisura me leje legalizimi në rastet si më lart në kundërshtim, me dispozitat e ligjit dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, dhe të fillojë procedurat për shfuqizimin e lejes së legalizimit. 2. Për pasuritë e regjistruar sipas lejeve legalizimi konstatuar të lëshuara me shkelje në raste e mësipërme të marrë masa në bazë të neni 27 pika 1 e 4 të ligjit 111, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën” të nxjerrë	13-27	E LARTË	Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Sarandë të marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI TEMATIK “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA” NË
DVASHK SARANDË

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJA E GJETJES	FAQE	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	urdhër kufizimi deri në plotësimin e dokumentacionit të kërkuar ligjor. -Të marrë masa dhe të vendoset masë kufizimi për këto pasuri deri në rikthimin e ligjshmërisë për këto pasuri. Rekomandim nr.6.1: Nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Sarandë, të marrën masa për plotësimin e dosjes me dokumentacionin e kërkuar ligjor për objektin informalë të pajisur me leje legalizimi si më lart. Rekomandim nr.8.1: Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Sarandë bazuar në nenin 27, pika 1 e 4, të ligjit nr.111, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, të kërkojë nga subjekti plotësimin e dosjes së lejes së legalizimit me akt-ekspertizës për qëndrueshmërinë e objekti, në të kundërt në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK Tiranë, të fillojë procedurat për shfuqizimin e lejes së legalizimit duke nxjerrë urdhër kufizimi deri në plotësimin e dokumentacionit të kërkuar ligjor. Rekomandim nr.10.1: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Sarandë të marrë masa dhe të rivlerësojë gjendjen juridike të pronave për subjektet: <i>nr.2968 E. M. A.; nr.02555 G. M. A.; nr.02554 K. V. M. dhe A. K. M.; nr.02557 Xh. A. O., nr.02564 A. N. M., nr.02566 N. H. Sh., nr.02596 P. M. T., nr.02586 K. Th. A., nr.02578 A. S. P., nr.02567 P. Sh. D., nr.02761 E. R. D., nr.02747 F. M. O., nr.02749 E. M. K., nr.02699 I. N. H. dhe E. N. H., nr.02714 N. S. V., nr.02710 Sh. S. M., nr.02704 E. A. R., nr.2833 D. Q. D., nr.02553 I. B. I., nr.02562 E. I. D. dhe Z. I. A., nr.02609 A. Ll. S., nr.02709 Xh. H. D., , nr.2746 A. S. R., nr.2647 K. V. L., nr.02674 H. Y. I., nr.02682 H. P. I., nr.02651 S. B. M., nr.02659 E. F. G., nr. 02660 F. M. Z. dhe të veprojë me përgjegjësi duke rikthyer ligjshmërinë e tyre.</i> Rekomandim nr.10.2: Për të ardhmen të mos kryhen regjistrime si akte administrative, (përfshirë leje legalizimi) për objektet informale, në kushtet e mosrespektimit të PPV të miratuar dhe të Zonës së Mbrojtur të miratuar me akte ligjore e nënligjore. Rekomandim nr.11.1: Drejtoria Vendore të ASHK Sarandë të marrë masa, bazuar në nenin 27, të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, duke vendosur kufizimin për pasuritë e regjistruar sipas referencave <i>nr.1713</i> ;			



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI TEMATIK “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA” NË
DVASHK SARANDË

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJA E GJETJES	FAQE	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	<i>nr.1699 ; nr.1700 ; nr.1702 ; nr.1703 ; nr.1689; nr. 1626 ; nr.2006 ; nr.2055 ; nr.01595 ; nr.01594 ; nr.01571 ; nr.01601 ; nr.01600; nr.1580 , deri në shqyrtimin dhe rivlerësimin edhe një herë nga sektori i legalizimit, të dokumentacionit tekniko ligjor, mbi bazën e të cilit janë lëshuar 15 lejet e legalizimit, duke njoftuar subjektet për fillimin e procedurave përkatëse sipas kërkesave të ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”.</i> Rekomandim nr.27.1: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Sarandë, të marrë masë për plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor dhe evidentimin e pagesës mbi shlyerjen e detyrimeve pranë Bashkisë Sarandë. Rekomandim nr.28.1: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë të marrë masa, që në zbatim të nenit 27, të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, të vendosë masë kufizimi, deri në plotësimin e dokumentacionit ligjor si dhe Preventivin sipas lejes së ndërtimit dhe situacioni përfundimtar, për të llogaritur diferencën e taksës së infrastrukturës nga ajo e paguar në Bashki dhe rikthimin e ligjshmërisë. Rekomandim nr.29.1: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë të marrë masa, që në zbatim të nenit 27, të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, të vendosë masë kufizimi deri në plotësimin e dokumentacionit ligjor, si Lejen e ndërtimi për ndërtim të përkohshëm si dhe Praktikës të bashkëngjitet Akti i vlerësimit dhe procesverbali të piketimit të truallit dhe rikthimin e ligjshmërisë . Rekomandim nr.30.1: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë të marrë masa, që në zbatim të nenit 27, të ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, të vendosë masë kufizimi për pasuritë e trajtuara në gjetjen nr.30. Rekomandim nr.34.1: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë të marrë masa, që në zbatim të nenit 27, të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, të vendosë masë kufizimi të vendosë masë kufizimi deri në plotësimin e dokumentacionit ligjor të kërkuar dhe rikthimin e ligjshmërisë, duke njoftuar subjektin B. K. për vendosjen e masë kufizimit dhe pas kalimit të afatit ligjor 30 ditor të kryejë regjistrimin e pronës në favor të qytetarit K. Th. K.			



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI TEMATIK “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA” NË
DVASHK SARANDË

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJA E GJETJES	FAQE	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	Rekomandim nr.35.1: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë të marrë masa, që në zbatim të nenit 27, të ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, të vendosë masë kufizimi për pasurinë e regjistruar sipas referencës nr.18018, ZK 8641, deri në plotësimin e dokumentacionit ligjor të kërkuar dhe rikthimin e ligjshmërisë. Rekomandim nr.38.1: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë, në zbatim të nenit 27, të Ligjit nr.111, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën” të marrë masa për vendosjen e masës së kufizimit për: - pasuritë nr.14/168 vol 22 fq 174 me qëllim kryerjen e veprimeve korrigjuese nga nocioni I në nocionin F, certifikatës familjare; - pasurinë nr.14/169 vol 22 fq 175, për diferencën në sipërfaqen e llojit “Truall” në masën 10 m²; kufizim për pasurinë 3/347/nd në volumnin nr.22 fq 22, me qëllim kryerjen e veprimeve përkatëse në seksionin B (përfshirjen e truallit në KPP), regjistrimin e kësaj pasurie me nocionin F, referuar certifikatës familjare, si dhe vendosjen e hipotekës ligjore në favor të DVASHK Sarandë në seksionin E për parcelën ndërtimore që do të miratohet me VKM; - pasurinë nr.14/169 vol 22 fq 184 me sipërfaqe 462 m² në pronësi shtet, në pasurinë nr.14/170 vol 22 fq 185 me sipërfaqe 73 m² në pronësi shtet, në pasurinë nr.14/172 vol 22 fq 187 me sipërfaqe 135 m² në pronësi shtet, si dhe në pasurinë nr.14/173 vol 22 fq 188 me sipërfaqe 448 m² në pronësi të P. B., me qëllim kryerjen e veprimeve përkatëse për sistemimin e diferencës së sipërfaqes prej 74 m², si dhe regjistrimin e pasurisë së legalizuar me lejen e legalizimit nr.62415 me nocionin F, referuar certifikatës familjare deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor të kërkuar dhe rikthimin e ligjshmërisë. Rekomandim nr.40.1: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë, të marrë masa: për evidentimin e 1252 praktikave në proces, kohëzgjatjen nga aplikimi, evidentimin e problematikave, krijimin e mbajtjes së evidencës së praktikave në proces, si dhe të marrë masa për inventarizimin e dokumentacionit për 1252 praktikat në proces e të pa përfunduara. Rekomandim nr.40.1: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë, të marrë masa: për evidentimin e 1252 praktikave në			



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI TEMATIK “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA” NË
DVASHK SARANDË

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJA E GJETJES	FAQE	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	proces, kohëzgjatjen nga aplikimi, evidentimin e problematikave, krijimin e mbajtjes së evidencës së praktikave në proces, si dhe të marrë masa për inventarizimin e dokumentacionit për 1252 praktikat në proces e të pa përfunduara. Rekomandim nr.41.1: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë të marrë masa, për regjistrimin hipotekor të lejes së legalizimit nr. 45569, datë 21.05. 2013, në përputhje e zbatim të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006”Për legalizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, si dhe nenit 53 të ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”. Rekomandim nr.45.1: Nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Sarandë të merren masa: Për zbatimin e Vendimit të Gjykatës së Lartë nr. 152, datë 16.03.2019 “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr. 20-2018-30/16 datë 16.01.2018 i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë”, për heqjen e sekuestrove konservative të vendosura sipas kërkesës me nr.1349 prot datë 16.02.2018 nga Zyra Përmbartimore “B.-K”; Si dhe për vazhdimin regjistrimi i pasurive që rrjedhin nga pasuria nr. 18/77 nd, në përputhje e zbatim të dokumentacionit ligjor të paraqitur për regjistrim dhe rikthimin e ligjshmërisë. Rekomandim nr.46.1: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Sarandë të marrë masa që në bashkëpunim me Bashkinë Sarandë të kërkojë në mënyrë zyrtare (me shkresë) për përcaktimin e saktë të gjurmës së objektit (të legalizuar e skualifikuar) me lejen nr. 1042826, datë 31.07.2019 “Godinë me funksion social-ekonomik me 2 kate”, dhe saktësimin e statusit tekniko juridik në lidhje me zonën C.2. Bredenesht Sarandë për të përcaktuar cenimin ose jo të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Sarandë miratuar Vendimin e KKT nr. 3, datë 16.10.2017. Me marrjen e shkresës të procedojë me rikthimin e ligjshmërisë të kësaj leje legalizimi. <u>B. Masa shpërblim dëmi ekonomik</u> Rekomandim nr.1.1: Nga Titullari i DRASHK Sarandë të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimin e vlerës 5,436,194 lekë, të ardhura të munguara me efekt dëm ekonomik, të krijuara nga mos llogaritjet e sakta të tatimit dhe taksës së			



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI TEMATIK “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA” NË
DVASHK SARANDË

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJA E GJETJES	FAQE	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	kalimit të të drejtave mbi pronën. <u>C. Masa të ardhura të munguara</u> Rekomandim nr.4.1: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë të marrë masa, që në zbatim të nenit 27, të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, të vendosë masë kufizimi deri në administrimin e dokumentacionit të pagesës së diferencës së truallit në vleftë prej 3,543,126 leke dhe të ndjekë në rrugë ligjore arkëtimin e taksës së kalimit të pronësisë në shumën 531,469 lekë. Rekomandim nr.5.1: Drejtoria Vendore e ASHK Sarandë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore deri në daljen e VKM-ve, për 16 dosje të objekteve informale të pajisur me Leje legalizimi të objektit, për të mundësuar brenda afateve ligjore likuidimin të vleftës të parcelave ndërtimore prej 19,158,879 lekë, si e ardhur e munguar për Buxhetin e shtetit dhe fondin e kompensimit të ish-pronareve.			

I.3. Konkluzione dhe opinioni i auditimit

Mbështetur në standardet e INTOSAI-t, Manualit të Përputhshmërisë, Manualit të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, nga auditimi tematik i kryer në DVASHK Sarandë, rezultoi se niveli i zbatimit të rekomandimeve plotësisht, pjesërisht ose në proces zbatimi, është në nivelin 20%. Nga rekomandimet e lëna në auditimin e mëparshëm për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 46 masa organizative, 5 masa për të ardhura të munguara, 1 shpërblim dëmi në vlerën 5,436,194 lekë dhe 14 masa disiplinore, nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna”.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

Për përmirësimin e gjendjes nga 46 masa organizative të lëna rekomandim nga KLSH, janë zbatuar plotësisht 3 rekomandime, zbatuar pjesërisht 4 rekomandime, janë në proces zbatimi 6 rekomandime dhe janë pazbatuar 17 rekomandime. Pjesa tjetër e rekomandimeve janë ezauruar për arsye të argumentuara në këtë Raport Përfundimtar Auditimi.

Për të ardhura të munguara janë lënë 5 rekomandime në vlerën 958,213,325 lekë (pranuar 4 dhe papranuar 1, zbatuar pjesërisht 3, plotësisht 1 dhe pazbatuar 1), nga të cilat janë arkëtuar 56,782,786 lekë, si dhe është lënë 1 rekomandim për shpërblim dëmi në vlerën 5,436,194 lekë i cili nuk është pranuar dhe nuk është zbatuar.

Janë lënë 14 masa disiplinore nga të cilat nuk është zbatuar asnjë prej tyre nga Drejtori i Përgjithshëm i ASHK.

II. HYRJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Sarandë (në vijim DVASHK) “Mbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2020”, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me: verifikimin e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI TEMATIK "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA" NË
DVASHK SARANDË

respektimit të afatit 20-ditor dhe 6-mujor për kthim përgjigje mbi përgatitjen e plan-veprimit dhe informacionin mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve; verifikimin e nivelit të zbatimit të masave për përmirësim ligjor, organizative, të ardhura të munguara dhe masave disiplinore.

Sipas Programit të Auditimit, nr.260/4, datë 15.02.2021, auditimi u krye nga grupi auditues, si vijon:

1. O. L., Auditues
2. H. M., Auditues

Titulli

Raport Përfundimtar i auditimit tematik, mbi verifikimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2020 të kryer në DVASHK Sarandë.

Marrësi

DVASHK Sarandë. Titullari i institucionit është zj. K. S., Drejtor.

Objektivat dhe qëllimi i auditimit

Ky auditim ka objektiv pasqyrimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm të kryer pranë DVASHK Sarandë, si dhe dhënien e opinionit objektiv e profesional mbi zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH në përmirësimin e punës menaxhuese të njësisë publike. Gjithashtu ka si qëllim raportimin mbi gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e auditimit.

Identifikimi i Çështjeve:

1. Hartimi i programit (plani i veprimit). Respektimi i afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjit nr. 154/2014, "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".
2. Zbatimi i rekomandimeve për përmirësimet në legjislacionin në fuqi. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.
3. Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.
4. Zbatimi i rekomandimeve për shpërblimin e dëmit ekonomik. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.
5. Zbatimi i rekomandimeve për përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.
6. Zbatimi i rekomandimeve për masa disiplinore dhe administrative. Fillimi i procedurave për dhënien e masave disiplinore dhe administrative. Sa rekomandime janë pranuar dhe ecuria e tyre për masat e dhëna.
7. Të tjera që rezultojnë gjatë auditimit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI TEMATIK “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA” NË
DVASHK SARANDË

DVASHK Sarandë, si një institucion publik, që është përgjegjës për menaxhimin e fondeve dhe pronës publike me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet, ka detyrimin ligjor që të zbatoj rekomandimet e auditimit të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, si dhe të informoj këtë të fundit, mbi nivelin pranimit, zbatimit dhe mos zbatimit të tyre.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim

Niveli drejtues i DVASHK Sarandë, ka detyrimin ligjor për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH, duke përgatitur plan-veprimin për zbatimin e tyre, informacionin mbi nivelin e zbatimit, si dhe duke nxjerrë rast pas rasti Urdhëra, Udhëzime, Rregullore, etj., me qëllim argumentimin e zbatimit të rekomandimeve.

Përgjegjësitë e audituesve

Audituesit janë përgjegjës për shprehjen e konkluzioneve dhe dhënien e një vlerësimi objektiv e profesional mbi zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH. Auditimi është bërë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit INTOSAI.

Kriteret e vlerësimit:

Në të gjitha fazat e auditimit, sipas programit të detajuar në përshtatje me Standardet e Auditimit dhe në referencë me problematikën, është patur si kriter vlerësues në radhë të parë:

- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Rregullorja e Procedurave të Auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit, e ndryshuar me Vendimin nr.107, datë 08.09.2017 të Kryetarit Të KLSH-së.
- Manuali për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe regjistri elektronik institucional, miratuar me Vendimin nr.67, datë 23.06.2020 të Kryetarit të KLSH-së.

Standardet e auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuara, si rrjedhojë edhe Raporti Përfundimtar i Auditimit është plotësuar sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë, Rregullores së Procedurave të Auditimit, Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.

Metodat e auditimit

1. Auditim i plotë sipas cilësimeve të bëra në drejtimet e auditimit.
2. Verifikimi i Urdhrëve, Udhëzimeve dhe çdo dokumenti ligjor të nevojshëm për zbatimin e rekomandimeve.

Dokumentimi i rezultateve të Auditimit

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar është përgatitur Raporti Përfundimtar i Auditimit, i cili do të jetë materiali bazë për ridërgimin e rekomandimeve.

III. PËRSHKRIMI I I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

DVASHK Sarandë është person juridik, publik jobuxhetor, në varësi të Ministrisë së Drejtësisë. Ka për detyrë regjistrimin e pasurive të paluajtshme dhe të gjitha ndryshimeve në lidhje me pasuritë e paluajtshme në bazë të kushteve të përcaktuara nga Ligji nr. 111/2018 “Për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI TEMATIK "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA" NË
DVASHK SARANDË

Kadastrën". Regjistrimi i pasurive të paluajtshme në rrethin e Sarandës drejtohet nga Drejtori. Drejtori organizon dhe drejton DVASHK Sarandë. Veprimtaria e DVASHK Sarandë mbështetet në parimet e sigurisë juridike, transparencës, ligjshmërisë dhe përparësisë në regjistrimin e pasurive të paluajtshme. Dispozitat e Ligjit nr.33, datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", i ndryshuar dhe ligjit nr.111/2018 "Për Kadastrën" zbatohen për periudhën objekt auditimi për regjistrimin e të gjitha pasurive të paluajtshme që shtrihen brenda territorit (juridiksionit) të Rrethit Sarandë, bazuar në aktet e fitimit të pronësisë apo krijimit të të drejtave reale mbi to, sipas kërkesave të paraqitura nga persona juridikë/fizikë, vendas apo të huaj.

2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

1. Hartimi i programit (plani i veprimit). Respektimi i afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjit nr. 154/2014, "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

1.Hartimi i plan-veprimit dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 gërma (j) të ligjit nr. 154/214, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

- Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 902/8 prot, datë 22.05.2020, ka dërguar në Drejtorinë Vendore të ASHK Sarandë Raportin Përfundimtar të Auditimit së bashku me rekomandimet përkatëse. Kjo shkresë është protokolluar në DVASHK Sarandë me nr.1368/30, datë 27.05.2020.

- Nga ish-Drejtori A. K. është nxjerrë Urdhëri nr.873, datë 05.06.2020 protokolluar me nr.4835, për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH nga specialistët e të gjithë sektorëve përkatës të prekur në Raportin Përfundimtar të KLSH, rast pas rasti sipas detyrave të gjithësecilit.

-Ish-Drejtori A. K. nuk ka marrë masa për hartimin e një plan veprimi në të cilin do të ishin përcaktuar rekomandimet e lëna nga KLSH, strukturat përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve, afatet për zbatimin e tyre, fondet e nevojshme, si dhe treguesi i rezultateve të arritura, në kundërshtim me Ligjin nr.154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, neni 15, gërma j.

Nga Drejtori K. S. nuk janë marrë masa për respektimin e afatit prej 6 (gjashtë) muajsh për raportimin në KLSH me anë të një informacioni të hollësishëm për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, në kundërshtim me Ligjin nr.154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, neni 30, pika 2.

Niveli i pranimit dhe statusi sipas llojit të rekomandimit në numër dhe në vlerë

Nga ana e KLSH me shkresën përcjellëse nr.902/8 prot, datë 22.05.2020 janë lënë **66** rekomandime gjithsej, nga këto: 46 masa organizative, 5 masa të ardhura të munguara në vlerën 963,649,519 lekë, 1 masë zhdëmtimi në vlerën 5,436,194 lekë, 14 masa disiplinore, nga "Vërejtje" deri në "Zgjidhje të kontratës së punës".

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

Për përmirësimin e gjendjes nga 46 masa organizative të lëna rekomandim nga KLSH, janë zbatuar plotësisht 3 rekomandime, zbatuar pjesërisht 4 rekomandime, janë në proces zbatimi 6 rekomandime dhe janë pazbatuar 17 rekomandime. Pjesa tjetër e rekomandimeve janë ezauruar për arsye të ndryshimeve ligjore ose shkaqe të tjera të argumentuara në këtë akt-konstatim.

Për të ardhura të munguara janë lënë 5 rekomandime në vlerën 958,213,325 lekë (pranuar 4 dhe papranuar 1, zbatuar pjesërisht 3, plotësisht 1 dhe pazbatuar 1), nga të cilat janë arkëtuar 56,782,786 lekë, si dhe është lënë 1 rekomandim për shpërblim dëmi në vlerën 5,436,194 lekë i cili nuk është pranuar dhe nuk është zbatuar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI TEMATIK “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA” NË
DVASHK SARANDË

Janë lënë 14 masa disiplinore nga të cilat nuk është zbatuar asnjë prej tyre.

Nr	Emërtimi	Rekomandimet ne numër :				Nga rekomandimet gjithsej: Sa me dëme ekonomike							
		Rekomandim gjithsej në numër	Nga rekomandimet janë:			Rekomanduar Gjithsej		Nga rekomandimet janë:					
			Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Në proces			Zbatuar arkëtuar		Zbatuar pjesërisht (në proces)		Pa zbatuar	
						Nr. per	Lekë	Nr. per	Lekë	Nr . Pers	Në mijë/lek	Nr . pers	Lekë
1.	Masa organizative	46	3	4	6	-	-	-	-	-	-	-	-
2	Shpërblim demi	1	-	-	-	-	5,436,194	-	-	-	-	-	5,436,194
3	Të ardhura të munguara	5	1	3	-	-	958,213,325		56,782,786	-	-	-	901,430,539
4	Masa disiplinore	14	0	0		14	-	-	-	-	-	14	
	Totali	66	4	7	6	14	963,649,519	-	-	-	-	-	906,866,733

2. Zbatimi i rekomandimeve për përmirësime në legjislacionin në fuqi. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

Duke qenë se nuk nga auditimi i mëparshëm i KLSH nuk janë lënë rekomandime për përmirësime ligjore atëherë kjo pikë e programit ezaurohet me këtë shënim.

3. Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar.

1.1- Rekomandimi: Drejtorit Vendore të ASHK Sarandë, për nevoja të plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor të objekteve me leje legalizimit të lëshuara, t'i kërkojë Bashkive Sarandë, Himarë, Finiq dhe Konispol, vërtetimet mbi llogaritjen dhe pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë në *vlerën prej 804,249,039 lekë, si dhe të kërkojë që të bëhet regjistrimi në sektorin përkatës të kartelës* në Drejtorinë Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Sarandë, *në refuzim të vendosen masë për kufizimin deri në arkëtimin e plotë të detyrimeve të papaguara.*

Brenda datës 30.07.2020

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht. Me shkresë nr.4907, datë 08.06.2020, DVASHK Sarandë ka kërkuar konfirmimin e pagesës së taksës së infrastrukturës Bashkive përkatëse, por nuk është vendosur kufizim deri në shlyerjen e likuidimit.

2.1- Rekomandimi: Drejtoria Vendore e ASHK Sarandë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore deri në daljen e VKM-ve, për **2035 dosje** të objekteve informale të pajisur me



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI TEMATIK “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA” NË
DVASHK SARANDË

Leje legalizimi të objektit, **për të mundësuar brenda afateve ligjore** likuidimin të vlefës përkatëse të parcelave ndërtimore.

Brenda datës 30.06.2020

Zbatimi: *Subjekti DVASHK Sarandë sqaron se me hyrjen në fuqi të Ligjit 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” ka filluar lëshimi i formularëve të pagesës dhe likuidimi i trullit për këto dosje.*

Komente: *Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **në proces zbatimi**.*

3.1- Rekomandimi: Drejtoria Vendore të ASHK Sarandë, të marrë masa që në vazhdimësi për objekte informale të pajisur me leje legalizimi të evidentojë respektimin e afateve të matjeve në terren, kualifikimin e tyre deri në lëshimin e lejes së legalizimit, si dhe për objektet informale për të cilat kanë përfunduar evidentimin faktik në terren të ndërtimeve pa leje, evidentimi i gjendjes juridike të trullit, si dhe hartimi i genplanit dhe planimetrive, por pa përfunduar procesi i legalizimit. Të operojë me vazhdimin e procedurave të legalizimit, duke i trajtuar në funksion të afatit kohor të qëndrimit në arkivë si dhe të bëhet dokumentimi i vazhdueshëm i lëvizjes së dosjeve që futen dhe nxirren nga arkiva për punë.

Në vijimësi

Zbatimi: *Subjekti DVASHK Sarandë sqaron se ka filluar filluar procedurat e verifikimit të respektimit të afatit kohor për 2928 praktika të vetëdeklarimit.*

Komente: *Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **në proces zbatimi**.*

4.1- Rekomandim: Drejtoria Vendore e ASHK Sarandë, të marrë masa dhe të vijojë me procedurat e marrjes së vendimit të skualifikimit apo kualifikimit të objekte informale sipas Tabelës “Objekte me problematika”, duke respektuar afatet ligjore dhe në zbatim të nenin 38 dhe 39, të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 me ndryshime.

Brenda datës 30.07.2020

Zbatimi: *Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, por është **në proces zbatimi**. Deri tani DVASHK Sarandë ka marrë vetëm një vendim për skualifikimin nga procesi i legalizimit për ndërtim me materiale të paqëndrueshme.*

5.1 Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Sarandë:

1. Në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK Tiranë, për objektet informale të pajisura me leje legalizimi në rastet si më lart në kundërshtim, me dispozitat e ligjit dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, **dhe të fillojë procedurat për shfuqizimin e lejes së legalizimit.**

2. Për pasuritë e regjistruar sipas lejeve legalizimi konstatuar të lëshuara me shkelje në raste e mësipërme të marrë masa në bazë të neni 27 pika 1 e 4 të ligjit 111, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën” **të nxjerrë urdhër kufizimi deri në plotësimin e dokumentacionit të kërkuar ligjor.**

-Të marrë masa dhe të vendoset masë kufizimi për këto pasuri deri në rikthimin e ligjshmërisë për këto pasuri.

Deri më datë 31.7.2020

Zbatimi: *Subjekti DVASHK Sarandë nuk ka filluar procedurat për shfuqizimin e lejeve të legalizimit të lëshuara në kundërshtim me ligjin, si dhe nuk është nxjerrë urdhër kufizimi deri në plotësimin e dokumentacionit të kërkuar ligjor.*

*Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, por **nuk është zbatuar**.*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI TEMATIK “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA” NË
DVASHK SARANDË

6.1- Rekomandim: Nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Sarandë, të marrën masa për plotësimin e dosjes me dokumentacionin e kërkuar ligjor për objektin informalë të pajisur me leje legalizimi si më lart.

Deri më datë 30.07.2020

Zbatimi: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, por **nuk është zbatuar**.

7.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Sarandë të marrë masa për **70 rastet e konstatuara e në vijim**, për të plotësuar “Proces verbalin e verifikimit në terren të dhënave të ndërtimit pa lejë/shitesës në ndërtimin me leje”, me të dhënat e kërkuara edhe me largësitë e bazës së objektit nga kufijtë e parcelës ndërtimin në raport me kufizimet dhe situatën ndërtimore rreth tij. Në rastin e mos plotësimit, të bashkëpunojë me Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë të Kadastrës Shtetërore për objektet informale të pajisura me leje legalizimi për të filluar procedurat për shfuqizimin e lejeve të legalizimit.

Deri më datë 30.07.2020

Zbatimi: Subjekti DVASHK Sarandë sqaron se ka filluar filluar procedurat e verifikimit të këtyre rasteve.

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe është **në proces zbatimi**.

8.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Sarandë bazuar në nenin 27, pika 1 e 4, të ligjit nr.111, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, të kërkojë nga subjekti plotësimin e dosjes së lejes së legalizimit me akt-ekspertizës për qëndrueshmërinë e objekti, në të kundërt në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK Tiranë, **të fillojë procedurat për shfuqizimin e lejes së legalizimit duke nxjerrë urdhër kufizimi deri në plotësimin e dokumentacionit të kërkuar ligjor.**

Deri më datë 30.07.2020

Zbatimi: Subjekti DVASHK Sarandë nuk ka kërkuar plotësimin e dokumentacionit ligjor.

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, por **nuk është zbatuar**.

9.1.Rekomandim: Drejtoria Vendore të ASHK Sarandë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore deri në daljen e VKM-ve, **për 16 dosje të objekteve informale të pajisur me Leje legalizimi të objektit, për të mundësuar brenda afateve ligjore likuidimin të vlefës përkatëse të parcelave ndërtimore dhe të mos kryejë asnjë transaksion pronësie pa u plotësuar ligjshmëria e tyre.**

Deri më datë 30.09.2020

Zbatimi: Subjekti DVASHK Sarandë sqaron se **do të ruajë hipotekën ligjore të vendosur deri në momentin e pagesës së parcelës ndërtimore.**

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **në proces zbatimi**.

10.1-Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Sarandë të marrë masa dhe të rivlerësojë gjendjen juridike të pronave për subjektet: nr.2968 E. M. A.; nr.02555 G. M. A. nr.02554 K. V. M. dhe A. K. M.; nr.02557 Xh. A. O., nr.02564 A. N. M., nr.02566 N. H. Sh. nr.02596 P. M. T., nr.02586 K. Th. A., nr.02578 A. S. P., nr.02567 P. Sh. D., nr.02761 E. R. D., nr.02747 F. M. O., nr.02749 E. M. K., nr.02699 I. N. H. dhe E. N. H., nr.02714 N. S. V., nr.02710 Sh. S. M., nr.02704 E. A. R., nr.2833 D. Q. D., nr.02553 I. B. I., nr.02562 E. I. D. dhe Z. I. A., nr.02609 A. Ll. S., nr.02709 Xh. H. D., , nr.2746 A. S. R., nr.2647 K. V. L., nr.02674 H. Y. I.,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI TEMATIK “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA” NË
DVASHK SARANDË

nr.02682 H. P. I., nr.02651 S. B. M., nr.02659 E. F. G., nr. 02660 F. M. Z. dhe të veprave me përgjegjësi duke rikthyer ligjshmërinë e tyre.

Deri më datë 30.09.2020

10.2 Rekomandim: Për të ardhmen të mos kryhen regjistrime si akte administrative, (përfshirë leje legalizimi) për objektet informale, në kushtet e mosrespektimit të PPV të miratuar dhe të Zonës së Mbrojtur të miratuar me akte ligjore e nënligjore.

Në vijimësi

Zbatimi: Subjekti DVASHK Sarandë sqaron se kanë vazhduar procedurat e legalizimit për shkak se me shkresë nr.332/1 prot., 16.01.2020 Drejtoria e Menaxhimit, Projekteve dhe Monitorimit në Ministrinë e Turizmit, ndërkohë që kjo shkresë i referohet se cilës hartë i duhet referuar DVASHK Sarandë për vijimin e procedurave të kualifikimit dhe se ende po vijohet me procedurat për heqjen e kësaj zone nga Parku Kombëtar i Butrintit.

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, por nuk është zbatuar.

11.1- Rekomandim: Drejtoria Vendore të ASHK Sarandë të marrë masa, bazuar në nenin 27, të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, **duke vendosur kufizimin për pasuritë e regjistruar sipas referencave nr.1713; nr.1699 ; nr.1700; nr.1702; nr.1703 ; nr.1689 ; nr. 1626; nr.2006; nr.2055; nr.01595; nr.01594; nr.01571; nr.01601; nr.01600 ; nr.1580, deri në shqyrtimin dhe rivlerësimin edhe një herë nga sektori i legalizimit, të dokumentacionit tekniko ligjor, mbi bazën e të cilit janë lëshuar 15 lejet e legalizimit, duke njoftuar subjektet për fillimin e procedurave përkatëse sipas kërkesave të ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”.**

Deri më datë 30.07.2020

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i papranuar, dhe i pazbatuar.

12.1 Rekomandim: Drejtoria Vendore të ASHK Sarandë të marrë masa, bazuar në nenin 27, të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, **duke vendosur kufizimin për pasuritë e regjistruar sipas referencave nr.2833 , nr.02553 , nr.02562 , nr.02609 , nr.02709 , nr.2746 , nr.2647 , deri në paraqitjen e dokumentacionit tekniko ligjor dhe rikthimin e ligjshmërisë.**

Deri më datë 30.07.2020

Zbatimi: Subjekti DVASHK Sarandë sqaron se e ka trajtuar këtë rekomandim, në mbështetje të nenit 32, të ligjit nr. 20/2020 “Për përfunimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” “Efektet e legalizimit në regjimin kadastral të tokës” “Legalizimi i ndërtimeve pa leje ndryshon automatikisht llojin e pasurisë në regjistrat publike të pasurive të paluajtshme, duke e kthyer sipërfaqen e parcelës ndërtimore në truall”.

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i papranuar dhe është ezauruar për shkak të ndryshimeve ligjore.

12.2 Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë të marrë masa për të ardhmen duke mos regjistruar në asnjë rast akte administrative, (përfshirë leje legalizimi) për objekte informale, në kushtet e mosrespektimit të PPV të miratuar dhe për raste të tjera të ndryshimit të zërit kadastral, me llojet e pasurive “Kullotë” dhe “Pyll” t’u drejtohet zyrtarisht institucioneve përkatëse për konfirmim në vazhdimin e procedurave.

Në vijimësi

Zbatimi: Subjekti DVASHK Sarandë sqaron se e ka trajtuar këtë rekomandim, në mbështetje të nenit 32, të ligjit nr. 20/2020 “Për përfunimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” “Efektet e legalizimit në regjimin kadastral të tokës” “Legalizimi i ndërtimeve pa leje



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI TEMATIK “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA” NË
DVASHK SARANDË

ndryshon automatikisht llojin e pasurisë në regjistrat publike të pasurive të paluajtshme, duke e kthyer sipërfaqen e parcelës ndërtimore në truall”.

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i papranuar** dhe **është ezauruar** për shkak të ndryshimeve ligjore.

13.1-Rekomandim: Drejtoria Vendore të ASHK Sarandë të marrë masa, bazuar në nenin 27, të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, **duke vendosur kufizimin për pasuritë e regjistruar sipas referencave** në ZK 2297, Ksamil, sipas referencave nr. 02659, nr. 02555, nr.02674, nr.02651, **deri në paraqitjen dokumentacionit tekniko ligjor dhe rikthimin e ligjshmërisë.**

Deri më datë 30.07.2020

Zbatimi: Subjekti DVASHK Sarandë sqaron se e ka trajtuar këtë rekomandim, në mbështetje të VKM nr.1040, datë 25.11.2020, pika II 15/a, e ndryshuar nuk legalizohet kur shkel trupin e rrugës së kategorisë C.

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe zbatimi i tij është ezauruar me hyrjen në fuqi të VKM nr.1040, datë 25.11.2020.

13.2 Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë, të marrë masa për të ardhmen dhe të mos pranojë regjistrimin e akteve administrative, në kushtet kur bëhet fjalë objekte në afërsi të rrugëve nacionale të kategorisë “C”, në një distancë më të vogël se 10 m nga buza e rrugës dhe për mosrespektimit të PPV të miratuar.

Në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i papranuar** dhe është ezauruar si pasojë e hyrjes në fuqi të VKM nr.1040, datë 25.11.2020, pika II 15/a, e ndryshuar.

14.1-Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë të marrë masa, bazuar në nenin 27, të ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, **duke vendosur masë kufizimi për pasurinë nr. 1/1085/ND, vol. 24, f. 148 ne emër A. S. R., deri në paraqitjen dokumentacionit tekniko ligjor dhe rikthimin e ligjshmërisë.**

Deri më datë 30.07.2020

Zbatimi: Subjekti DVASHK Sarandë sqaron se e ka trajtuar këtë rekomandim, por nuk mund ta zbatojë për shkak se në mbështetje të VKM nr.280, datë 01.04.2020, kjo leje legalizimi nuk është regjistruar në sipërfaqe funksionale të objekteve të kultit por bie mbi pasuri të llojit “Kullotë” me nr.1/692 vol.13 faqe.163, me sipërfaqe 25000m² regjistruar në ZK2297.

15.1-Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë të marrë masa, bazuar në nenin 27, të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, **duke vendosur masë kufizimin për pasuritë e regjistruar sipas referencave nr.4440, 4419, 4490, 4502, 4486 , 4499 , 4524 , 4521, deri në plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm tekniko-ligjor dhe rikthimin e ligjshmërisë.**

Deri më datë 30.07.2020

Zbatimi: Subjekti DVASHK Sarandë sqaron se AMTP-të origjinale janë në arkivë dhe se përfituesit e AMTP-ve janë konfirmuar nga Bashkia Delvinë si përfitues të tokës bujqësore.



KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI TEMATIK "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA" NË
DVASHK SARANDË

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i papranuar, por është ezauruar për shkak se nga verifikimi i bërë referencave përkatëse rezultoi se argumentimi i DVASHK Sarandë qëndron, e për pasojë zbatimi i rekomandimit nuk mund të kryhet.

16.1-Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë të marrë masa, bazuar në nenin 27, të ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 "Për Kadastrën", **duke vendosur masë kufizimi për pasuritë e regjistruara sipas referencave nr.0182, 0184, 0189, 0188, deri në plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm tekniko-ligjor dhe rikthimin e ligjshmërisë.**

Deri më datë 30.07.2020

Zbatimi: Subjekti DVASHK Sarandë sqaron se e ka trajtuar këtë rekomandim, në mbështetje të nenit 9, pika 1 të ligjit nr. 20/2020 "Për përfunimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë" "Efektet e legalizimit në regjimin kadastral të tokës" "AMTP-të që janë regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk shqyrtohen nga ASHK-ja, sipas parashikimeve të nenit 7 të tij. Përfituesit e titujve të regjistruar disponojnë lirisht pasuritë, përveç rastit të regjistrimeve të mbivendosura, të cilat, kur nuk mund të zgjidhen sipas parashikimeve të nenit 65, të këtij ligji, dhe kreut VI, të ligjit "Për kadastrën", zgjidhen gjyqësisht.". Bazuar mbi këtë arsyetim DVASHK Sarandë nuk mund të procedojë me vendosjen e masave të kufizimit në referencat për të cilat KLSH ka konstatuar këtë problematikë.

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i papranuar, dhe është ezauruar për shkak të ndryshimeve ligjore.

17.1-Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë të marrë masa, bazuar në nenin 27, të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 "Për Kadastrën", **duke vendosur masë kufizimi për pasuritë e regjistruar sipas referencave nr.078, 090, 079, deri në plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm tekniko-ligjor dhe rikthimin e ligjshmërisë.**

Deri më datë 30.07.2020

Zbatimi: Subjekti DVASHK Sarandë sqaron se e ka trajtuar këtë rekomandim, në mbështetje të nenit 9, pika 1 të ligjit nr. 20/2020 "Për përfunimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë" "Efektet e legalizimit në regjimin kadastral të tokës" "AMTP-të që janë regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk shqyrtohen nga ASHK-ja, sipas parashikimeve të nenit 7 të tij. Përfituesit e titujve të regjistruar disponojnë lirisht pasuritë, përveç rastit të regjistrimeve të mbivendosura, të cilat, kur nuk mund të zgjidhen sipas parashikimeve të nenit 65, të këtij ligji, dhe kreut VI, të ligjit "Për kadastrën", zgjidhen gjyqësisht." Bazuar mbi këtë arsyetim DVASHK Sarandë nuk mund të procedojë me vendosjen e masave të kufizimit në referencat për të cilat KLSH ka konstatuar këtë problematikë.

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i papranuar, dhe është ezauruar për shkak të ndryshimeve ligjore.

18.1-Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë të marrë masa, bazuar në nenin 27, të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 "Për Kadastrën", duke vendosur masë kufizimi për pasurinë e regjistruar sipas referencës nr.079 për Dhimitri Miho Kondi, **deri në plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm tekniko-ligjor dhe rikthimin e ligjshmërisë dhe regjistrimin e pasurisë Hristo Miho Kondi në përputhje me dokumentacionin e kërkuar tekniko-ligjor.**

Deri më datë 30.07.2020



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI TEMATIK “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA” NË
DVASHK SARANDË

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i papranuar, dhe është ezauruar për shkak se nga Bashkia Finiq janë përcjellë shkresat të cilat vërtetojnë përfitimin e tokës bujqësore në emër të Dhimitri Hondi dhe Hristo Kondi sipas pjesëve takuese dhe se me shkresë nr.397, datë 06.02.2018 është konfirmuar se shtetasi Hristo Kondi është i njëjti me Kristaq Kondi vërtetuar kjo sipas Zyrës së Gjendjes Civile Mesopotam.

19.1-Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë të marrë masa, bazuar në nenin 27, të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, **duke vendosur masë kufizimi për pasuritë e regjistruar sipas referencës nr.037 për V. S. K., deri në plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm tekniko-ligjor dhe rikthimin e ligjshmërisë.**

Deri më datë 30.07.2020

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i papranuar, për shkak se në praktikën e regjistrimit ndodhen dokumentacioni i nevojshëm për regjistrim në zbatim të VKM nr.329, datë 22.5.2019 “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës së bashkive me agjencinë shtetërore të kadastrës, për regjistrimin e trojeve të dhëna për ndërtim nga njësitë e qeverisjes vendore dhe për rregullimin e marrëdhënieve juridike të pronësisë mbi këto troje, për efekt regjistrimi”

20.1-Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë të marrë masa, bazuar në nenin 27, të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, **duke vendosur masë kufizimi për pasuritë e regjistruar sipas referencës nr.033, deri në plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm tekniko-ligjor dhe rikthimin e ligjshmërisë.**

Deri më datë 30.07.2020

Zbatimi: Subjekti DVASHK Sarandë sqaron se e ka trajtuar këtë rekomandim, në mbështetje të nenit 9, pika 1 të ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” “Efektet e legalizimit në regjimin kadastral të tokës” “AMTP-të që janë regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk shqyrtohen nga ASHK-ja, sipas parashikimeve të nenit 7 të tij. Përfituesit e titujve të regjistruar disponojnë lirisht pasuritë, përveç rastit të regjistrimeve të mbivendosura, të cilat, kur nuk mund të zgjidhen sipas parashikimeve të nenit 65, të këtij ligji, dhe kreut VI, të ligjit “Për kadastrën”, zgjidhen gjyqësisht.”. Bazuar mbi këtë arsyetim DVASHK Sarandë nuk mund të procedojë me vendosjen e masave të kufizimit në referencat për të cilat KLSH ka konstatuar këtë problematikë.

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i papranuar, dhe është ezauruar për shkak të ndryshimeve ligjore.

21.1-Rekomandim: - Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë të marrë masa, bazuar në nenin 27, të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, **duke vendosur masë kufizimi për pasurinë nr.1399, vol.8, f.123, ZK 2963, deri në plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm tekniko-ligjor dhe rikthimin e ligjshmërisë.**

Deri më datë 30.07.2020

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i papranuar dhe është ezauruar për shkak se bashkëngjitur Vendimit të Gjykatës gjendet plani i rilevimit.

22.1-Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë të marrë masa, bazuar në nenin 27, të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, **duke vendosur masë kufizimi**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI TEMATIK "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA" NË
DVASHK SARANDË

për pasurinë nr.24/355, vol.37, f. 248, ZK 8642, Sarandë për A. T. H., deri në plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm tekniko-ligjor dhe rikthimin e ligjshmërisë.

Deri më datë 30.07.2020

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i papranuar, dhe i ezauruar për shkak se akti i kolaudit është nënshkruar nga palët përkatëse dhe se dokumentacioni i kërkuar nga ligji ndodhet në dosje.

23.1-Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë të marrë masa, bazuar në nenin 27, të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 "Për Kadastrën", **duke vendosur masë kufizimin për pasuritë e regjistruar sipas referencave nr. 17324; nr.17122; nr.17440, deri në plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm tekniko-ligjor dhe rikthimin e ligjshmërisë.**

Deri më datë 30.07.2020

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i papranuar, dhe i zbatuar pjesërisht për shkak se në referencën nr.17440 gjendet konfirmimi i Bashkisë Sarandë se objekti ka qenë i ndërtuar para datës 10.08.1991, vërtetuar kjo edhe me hartën e vitit 1982 bashkëngjitur shkresës nr.629/1 prot., datë 10.04.2020.

24.1.Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë të marrë masa, që në zbatim të nenit 27, të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 "Për Kadastrën", **të vendosë masë kufizimi, për pasurinë e regjistruar me leje legalizimi nr.1042737, datë 26.06 2019 e qytetarit Festim Malaj, deri në plotësimin e dokumentacionit për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe rikthimin e ligjshmërisë.**

Deri më datë 30.08.2020

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i papranuar, për shkak se subjekti e ka kryer pagesën e taksës së infrastrukturës më datë 07.06.2019 në vlerën 26846 lekë nëpërmjet T. B.

25.1.Rekomandimi : Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë të marrë masa, që në zbatim të nenit 27, të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 "Për Kadastrën", të vendosë masë kufizimi, për pasurinë e regjistruar sipas leje legalizimi nr.1040331, datë 31.1 2016, **deri në plotësimin e dokumentacionit për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe rikthimin e ligjshmërisë.**

Deri më datë 30.07.2020

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i papranuar, për shkak se subjekti e ka kryer pagesën e taksës së infrastrukturës më datë 01.06.2010 në vlerën 28881 lekë me mandatpagesën me nr. serial 0059647.

26.1.Rekomandimi : Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë të marrë masa, që në zbatim të nenit 27, të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 "Për Kadastrën", **të vendosë masë kufizimi për pasurinë e regjistruar sipas kërkesës nr.5126, datë 24.08.2019, deri në plotësimin e dokumentacionit ligjor dhe rikthimin e ligjshmërisë**, si: Preventivi sipas lejes së ndërtimit dhe situacioni përfundimtar, për të llogaritur diferencën e taksës së infrastrukturës nga ajo e paguar në Bashki.

-Të depozitohet albumi i shitjeve dhe aneksi kontratës nr.670 Rep. dhe 2495 Kol. datë 13.12.2008, për përcaktimin e pjesëve në natyrë të lidhura ndërmjet pronarit të truallit dhe investitorit.

Deri më datë 30.08.2020

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i papranuar, për shkak se në dosje ndodhet aneks-kontrata nr.3184 rep. Nr.1206/1 kol., për përcaktimin e pjesëve në natyrë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI TEMATIK “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA” NË
DVASHK SARANDË

27.1. -Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Sarandë, të marrë masë për plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor dhe evidentimin e pagesës mbi shlyerjen e detyrimeve pranë Bashkisë Sarandë.

Brenda datës 30.08.2020

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, por i pazbatuar.

28.1.Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë të marrë masa, që në zbatim të nenit 27, të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, të vendosë masë kufizimi, deri në plotësimin e dokumentacionit ligjor si dhe Preventivin sipas lejes së ndërtimit dhe situacioni përfundimtar, për të llogaritur diferencën e taksës së infrastrukturës nga ajo e paguar në Bashki dhe rikthimin e ligjshmërisë

Deri më datë 30.08.2020

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, por i pazbatuar.

29.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë të marrë masa, që në zbatim të nenit 27, të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, të vendosë masë kufizimi deri në plotësimin e dokumentacionit ligjor, si Lejen e ndërtimi për ndërtim të përkohshëm si dhe Praktikës të bashkëngjitet Akti i vlerësimit dhe procesverbali të piketimit të truallit dhe rikthimin e ligjshmërisë .

Deri më datë 30.07.2020

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i papranuar, dhe i pazbatuar.

30.1.Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë të marrë masa, që në zbatim të nenit 27, të ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, të vendosë masë kufizimi për:

K. Q.	aplikim nr. 2928, datë 30.04.2018,		
Th. J. D.	aplikim nr. 3529, datë 06.02.2018,		
F. K.	Applikim nr.1808, datë 21.08.2018,		
Dh. I.	referencë 0361,		ZK 2264
G. Z.,	referencë 0153,	vol 1 faqe 81,	ZK 1472,
J. B.	referencë 0152	Vol 1 faqe 4	ZK 1472
S. K.	referencë 0154	vol 1 faqe 20	ZK 1472,
M. L.	referencë 0182	vol 12 faqe 101	ZK 1483,
Th. Zh.	referencë 0184	vol 12 faqe 182	ZK 1483,
S. Z.	referencë 0186	vol 3 faqe 212	ZK 1483,
Th. R.	referencë 0188	vol 8 faqe 189	ZK 1483,
K. Zh.	referencë 0189	vol 15 faqe 69	ZK 1483,
Dh. Ll.	referencë 0202	vol 11 faqe 23	ZK 1483,
Ll. K.	referencë 0200	vol 7 faqe 53	ZK 1483,
H. K.	referencë 077	vol 1 faqe 161	ZK 1848,
Dh. K.	referenca 078,	vol 1 faqe 62	ZK 1848,
V. N.	referencë 079	vol 1 faqe 123	ZK 1848,
M L.	referencë 090	vol 1 faqe 93	ZK 1848,
J. K.	referencë 095	vol 2 faqe 145	ZK 1848,
I. G.	referencë 0033	vol 1 faqe 38	ZK 1923,
V. K.	referencë 0034	vol 3 faqe 207	ZK 1923,
F. K.	referencë 0090	vol 1 faqe 96	ZK 2082,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI TEMATIK “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA” NË
DVASHK SARANDË

Q. Q.	referencë 0092	vol 3 faqe 48	ZK 2082,	
K. Q.	referenca 0093	vol 1 faqe 112	ZK 2082,	
G. Z.	referenca 0100	vol 1 faqe 111	ZK 2082,	
Th. D.	referenca 0101	vol 1 faqe 98	ZK 2082,	
I. M.	referenca 03061	vol 5 faqe 46	ZK 2264,	
S. M.	referenca 0381	vol 1 faqe 84	ZK 2264,	
K. D.	referencë 03091	vol 2 faqe 90	ZK 1413,	
V. K.	referenca 0065	vol 5 faqe 27	ZK 1269,	
T. C	referenca 0031	vol 4 faqe 93	ZK 2212,	deri në plotësimin e dokumentacionit ligjor të kërkuar dhe rikthimin e ligjshmërisë.

Deri më datë 30.08.2020

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i papranuar**, dhe i **pazbatuar**.

31.1.Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë të marrë masa, që në zbatim të nenit 27, të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, **të vendosë masë kufizimi për pasurinë e qytetarit N. A. deri në plotësimin e dokumentacionit ligjor të kërkuar dhe rikthimin e ligjshmërisë sipas certifikatës e gjendjes familjare të datës 01.10.1992, duke përfshirë në kartelën e pasurisë së paluajtshme të familjes bujqësore të N. A. edhe anëtarin e familjes M. A. duke e bërë me të drejta të plota pronësie.**

Deri më datë 30.08.2020

Komente: Kufizimi është vendosur mbi këtë pasuri sipas masës së sigurimit të padisë të vendosur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë (referencë nr.092, datë 12.08.2019). Më pas është hequr masa e sigurimit të padisë me referencën nr.103 mbi bazën e Vendimit të Gjykatës për pjesëtimin e pasurisë në emër të B. A., M. A., V. A., Sh. A. dhe B. A.

32.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë të marrë masa, që në zbatim të nenit 27, të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, **të vendosë masë kufizimin për pasurinë në emër të qytetarit B. N. A. deri në plotësimin e dokumentacionit ligjor të kërkuar dhe rikthimin e ligjshmërisë dhe të kryhet regjistrimi në përputhje të dëshmisë testamentare sipas shqyrtimit dhe regjistrimit të AMTP nr.12, vetëm për sipërfaqja 2925 m² (8776 : 3) .**

Deri më datë 30.08.2020

Komente: Kufizimi është vendosur mbi këtë pasuri sipas masës së sigurimit të padisë të vendosur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë (referencë nr.092, datë 12.08.2019). Më pas është hequr masa e sigurimit të padisë me referencën nr.103 mbi bazën e Vendimit të Gjykatës për pjesëtimin e pasurisë në emër të B. A., M. A., V. A., Sh. A. dhe B. A.

33.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë të marrë masa, që në zbatim të nenit 27, të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, **të vendosë masë kufizimi deri në plotësimin e dokumentacionit ligjor të kërkuar dhe rikthimin e ligjshmërisë për pasurinë e shitur sipas kontratës nr. 2839 rep, 1104/1 kol dat 20.06.2012, ku të përfshihet edhe i biri tjetër i N. dhe M. i quajtur M. N. A., vërtetuar me certifikatën e gjendjes familjare datë 01.10.1992 si pronar në bashkëpronësi me AMTP.**

Deri më datë 30.09.2020

Komente: Kufizimi është vendosur mbi këtë pasuri sipas masës së sigurimit të padisë të vendosur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë (referencë nr.092, datë 12.08.2019). Më pas është hequr masa e sigurimit të padisë me referencën nr.103 mbi bazën e Vendimit të Gjykatës për pjesëtimin e pasurisë në emër të B. A., M. A., V. A., S. A. dhe B. A.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI TEMATIK “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA” NË
DVASHK SARANDË

34.1. Rekomandimi : Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë të marrë masa, që në zbatim të nenit 27, të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, **të vendosë masë kufizimi të vendosë masë kufizimi deri në plotësimin e dokumentacionit ligjor të kërkuar dhe rikthimin e ligjshmërisë, duke njoftuar subjektin B. K. për vendosjen e masë kufizimit dhe pas kalimit të afatit ligjor 30 ditor të kryejë regjistrimin e pronës në favor të qytetarit K. Th. K.**

Deri më datë 30.08.2020

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i papranuar**, dhe **i pazbatuar**.

35.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë të marrë masa, që në zbatim të nenit 27, të ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, **të vendosë masë kufizimi për pasurinë e regjistruar sipas referencës nr.18018, ZK 8641, deri në plotësimin e dokumentacionit ligjor të kërkuar dhe rikthimin e ligjshmërisë**

Deri më datë 30.09.2020

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **i pazbatuar**.

36.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë të marrë masa, që në zbatim të nenit 27, të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, për pronën e kthyer sipas Vendimit nr.257, datë 10.07.2008, **të mos kryhen veprime mbi pasurinë deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor të kërkuar dhe rikthimin e ligjshmërisë për diferencën e pa regjistruar të sipërfaqes prej 34.15 ha.**

Deri më datë 30.08.2020

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **në proces zbatimi**.

37.1.- Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë, në zbatim të nenit 27, të Ligjit nr. 111, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën” **të marrë masa për vendosjen e masës së kufizimit mbi pasuritë nr.147/15, Vol 1, fq.151 dhe nr.18/723 Vol 23, fq.66, ZK 1464 deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor të kërkuar, rregullimin e të metave në procedurën e regjistrimit dhe rikthimin e ligjshmërisë .**

Deri në datë 30.08.2020

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i papranuar**, dhe **i zbatuar pjesërisht** pasi për shtetasin H. A. është depozituar vërtetimi për ndryshimin e emrit dhe se korrigjimi i nr. të AMTP nuk përbën shkak për pavlefshmërinë e aktit administrativ.

38.1.Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë, në zbatim të nenit 27, të Ligjit nr.111, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën” **të marrë masa për vendosjen e masës së kufizimit për:**

- pasuritë nr.14/168 vol 22 fq 174 me qëllim kryerjen e veprimeve korrigjuese nga nocioni I në nocionin F, certifikatës familjare;
- pasurinë nr.14/169 vol 22 fq 175, për diferencën në sipërfaqen e llojit “Truall” në masën 10 m²; kufizim për pasurinë 3/347/nd në volumin nr.22 fq 22, me qëllim kryerjen e veprimeve përkatëse në seksionin B (përfshirjen e truallit në KPP), regjistrimin e kësaj pasurie me nocionin F, referuar certifikatës familjare, si dhe vendosjen e hipotekës ligjore në favor të DVASHK Sarandë në seksionin E për parcelën ndërtimore që do të miratohet me VKM;
- pasurinë nr.14/169 vol 22 fq 184 me sipërfaqe 462 m² në pronësi shtet, në pasurinë nr.14/170 vol 22 fq 185 me sipërfaqe 73 m² në pronësi shtet, në pasurinë nr.14/172 vol 22 fq 187 me sipërfaqe 135 m² në pronësi shtet, si dhe në pasurinë nr.14/173 vol 22 fq 188 me sipërfaqe 448 m² në pronësi të Petrit Ballaci, me qëllim kryerjen e veprimeve përkatëse për sistemimin e diferencës së sipërfaqes prej 74 m², si dhe regjistrimin e pasurisë së legalizuar me lejen e legalizimit



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI TEMATIK “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA” NË
DVASHK SARANDË

nr.62415 me nocionin F, referuar certifikatës familjare **deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor të kërkuar dhe rikthimin e ligjshmërisë .**

Deri në datë 30.08. 2020

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, por **i pazbatuar**.

39.1 Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë, në zbatim të nenit 27, të Ligjit nr.111, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën” të, të marrë masa për pasurinë e regjistruar me referencën me nr.6909, ZK 8642 **duke vendosur masë kufizimi mbi këtë pasuri deri në plotësimin e dokumentacionit (mandat pagesa për shërbimet e kryera pranë DVASHK Sarandë), deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor të kërkuar dhe rikthimin e ligjshmërisë .**

Deri në datë 30.08. 2020

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar**. Mandatpagesa në vlerën 7000 leke është kryer në datë 09.01.2018 dhe u depozitua në praktikën dokumentare.

40.1-Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë, të marrë masa: për evidentimin e 1252 praktikave në proces, kohëzgjatjen nga aplikimi, evidentimin e problematikave, krijimin e mbajtjes së evidencës së praktikave në proces, si dhe të marrë masa për inventarizimin e dokumentacionit për 1252 praktikat në proces e të pa përfunduara.

Deri në datë 30.09. 2020

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, por **i pazbatuar**.

41.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë të marrë masa, **për regjistrimin hipotekor të lejes së legalizimit nr. 45569, datë 21.05. 2013, në përputhje e zbatim të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006”Për legalizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, si dhe nenit 53 të ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”.**

Deri me datë 30.06.2020

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, por **i pazbatuar**.

42.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë të marrë masa, që në zbatim të nenit 27, të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, të vendosë masë kufizimi për pasurinë pronarë sipas regjistrimit hipotekor nr.1, të apartamenteve, faqe 78, indeksi 229, datë 10.09.1996, të një “*apartment banimi nr.1, në banesën nr.4, lagja nr. 4, Sarandë, rruga nr.2,* deri në plotësimin e dokumentacionit në zbatim vetëm të Vendimit të Gjykatës së Kasacionit me nr.893 datë 04.07.1996. Aktualisht DVASHK Sarandë të ruajë gjendjen e kufizimit të pasurisë për mos kryerjen e veprimeve të tjera regjistruese, **deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor të kërkuar dhe rikthimin e ligjshmërisë .**

Menjëherë

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **i zbatuar**. DVASHK Sarandë ka njoftuar me shkresë nr.8443/1, datë 11.09.2020 shtetasen duke e orientuar për trajtim në Agjencinë e Trajtimt të Pronave.

43.1-Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë, të marrë masa të menjëhershme duke ndjekur të gjithë procedurat ligjore në shqyrtimin e dokumentacionit të dorëzuar (vendimi i Gjykatës Sarandë nr. 172 rep., nr. 280.kol.), etj, dokumente, duke u shprehur në mënyrë shkresore brenda afateve të përcaktuara ligjërisht mbi rezultatet e konkluduara, **deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor të kërkuar dhe rikthimin e ligjshmërisë.**

Menjëherë

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI TEMATIK “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA” NË
DVASHK SARANDË

44.1-Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë, të marrë masa të menjëhershme dhe të lajmërojë pronarët ankues E. V., K. V., A. V., A. V., S. V. (R.), të plotësojnë dokumentacionin tekniko-ligjor të konstatuar me mangësi sipas gjetjes nr. 30, të Raportit Përfundimtar të KLSH, duke ndjekur të gjithë procedurat ligjore në përputhje me përcaktimet e ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën” dhe të aplikojë sipas VKM nr.329, datë 22.05.2019, për të përfutur nga benefitet që parashikon ky vendim lidhur me regjistrimin e trojeve të shitura nga Bashkia Sarandë, **deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor të kërkuar dhe rikthimin e ligjshmërisë.**

Deri në datë 30.06. 2020

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar pjesërisht.** DVASHK Sarandë me anë të shkresës nr.4064, datë 11.05.2020 ka kërkuar konfirmimin e dokumentacionit nga ana e Bashkisë Sarandë e cila ka kthyer përgjigje me shkresën nr.1591/I, datë 29.05.2020, por nuk është vijuar me heqjen e kufizimit.

45.1. Rekomandim: Nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Sarandë të merren masa: Për zbatimin e Vendimit të Gjykatës së Lartë nr. 152, datë 16.03.2019 “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr. 20-2018-30/16 datë 16.01.2018 i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë”, për heqjen e sekuestrove konservative të vendosura sipas kërkesës me nr.1349 prot datë 16.02.2018 nga Zyra Përmbartimore “Blek-K”; Si dhe për vazhdimin regjistrimi i pasurive që rrjedhin nga pasuria nr. 18/77 nd, në përputhje e zbatim të dokumentacionit ligjor të paraqitur për regjistrim dhe rikthimin e ligjshmërisë.

Menjëherë

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i papranuar** dhe **i pazbatuar.**

46.1. Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Sarandë të marrë masa që në bashkëpunim me Bashkinë Sarandë të kërkojë në mënyrë zyrtare (me shkresë) për përcaktimin e saktë të gjurmës së objektit (të legalizuar e shkualifikuar) me lejen nr. 1042826, datë 31.07.2019 “Godinë me funksion social-ekonomik me 2 kate”, dhe saktësimin e statusit tekniko juridik në lidhje me zonën C.2. Bredenesh Sarandë për të përcaktuar cenimin ose jo të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Sarandë miratuar Vendimin e KKT nr. 3, datë 16.10.2017. Me marrjen e shkresës të procedojë me rikthimin e ligjshmërisë të kësaj leje legalizimi.

Menjëherë

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i papranuar** dhe **i pazbatuar.**

4. Zbatimi i rekomandimeve për shpërblimin e dëmit ekonomik. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

1.1 Rekomandim: Nga Titullari i DVASHK Sarandë të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës 5,436,194lekë, të ardhura të munguara me efekt dëm ekonomik, të krijuara nga mos llogaritjet e sakta të tatimit dhe taksës së kalimit të të drejtave mbi pronën.

Menjëherë

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i papranuar** dhe **i pazbatuar.**



5. Zbatimi i rekomandimeve për përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

1.1- Rekomandimi: Drejtorit Vendore të ASHK Sarandë, për nevoja të plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor të objekteve me leje legalizimit të lëshuara, t’i kërkojë Bashkive Sarandë, Himarë, Finiq dhe Konispol, vërtetimet mbi llogaritjen dhe pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë në ***vlerën prej 804,249,039 lekë, si dhe të kërkojë që të bëhet regjistrimi në sektorin përkatës të kartelës*** në Drejtorinë Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Sarandë, ***në refuzim të vendosen masë për kufizimin deri në arkëtimin e plotë të detyrimeve të papaguara.***

Brenda datës 30.09.2020

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar pjesërisht**. Me shkresën nr.1620/1, datë 02.07.2020 Bashkia Himarë informon DVASHK Sarandë se taksën e ndikimit në infrastrukturë për Bashkinë Himarë (periudha 01.01.2016 – 31.12.2019) e kanë paguar 40 subjekte në vlerën totale prej 2,792,611 lekë. Ndërsa me shkresën nr.546/1, datë 15.06.2020 Bashkia Konispol informon DVASHK Sarandë se taksën e ndikimit në infrastrukturë për Bashkinë Konispol (periudha 01.01.2016 – 15.6.2020) e kanë paguar 324 subjekte në vlerën totale prej 10,324,261 lekë.

2.1- Rekomandimi: Drejtoria Vendore të ASHK Sarandë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore deri në daljen e VKM-ve, për **2035 dosje** të objekteve informale të pajisur me Leje legalizimi të objektit, **për të mundësuar brenda afateve ligjore** likuidimin të vlefës përkatëse të parcelave ndërtimore.

Brenda datës 30.09.2020

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar pjesërisht**, pasi VKM-ja është miratuar për 243 subjekte në vlerën 41,831,412 lekë nga detyrimi total prej 135,327,500 lekë.

3.1. -Rekomandimi: Nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Sarandë, të marrin masa **për plotësimin e dokumentacionit ligjor dhe evidentimin e pagesës mbi shlyerjen e detyrimeve pranë Bashkisë Sarandë dhe rikthimin e ligjshmërisë.**

Brenda datës 30.07.2020

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**. Pagesat janë kryer nga subjekti nëpërmjet bankës Societe Generale Albania më datë 21.12.2017 me nr.vepr.008983 në vlerën 1,143,576 lekë dhe më datë 20.12.2017 me nr.vepr.008977 në vlerën 690,926 lekë.

4.1. -Rekomandimi : Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë të marrë masa, që në zbatim të nenit 27, të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, **të vendosë masë kufizimi deri në administrimin e dokumentacionit të pagesës së diferencës së truallit në vlefë prej 3,543,126 leke dhe të ndjekë në rrugë ligjore arkëtimin e taksës së kalimit të pronësisë në shumën 531,469 lekë.**

Brenda datës 30.07.2020

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i papranuar** dhe **i pazbatuar**, me argumentin se Nevruz Agako ka autorizuar me prokurë të përgjithshme datë 18.11.2013 autorizimin e babait të tij Petrit Agako për ldhjen e kontratës së shitjesblerjes së truallit. Kontrata me nr.2418 rep., nr.1203/1 kol. Për shitjen e truallit është lidhur midis P. A. dhe Sh. C.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI TEMATIK “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA” NË
DVASHK SARANDË

5.1.Rekomandim: Drejtoria Vendore e ASHK Sarandë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore deri në daljen e VKM-ve, **për 16 dosje** të objekteve informale të pajisur me Leje legalizimi të objektit, për të mundësuar brenda afateve ligjore likuidimin të vleftës të parcelave ndërtimore **prej 19,158,879 lekë**, si e ardhur e munguar për Buxhetin e shtetit dhe fondin e kompensimit të ish-pronareve.

Deri më datë 30.09.2020

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, por **i pazbatuar**.

6. Zbatimi i rekomandimeve për masa disiplinore dhe administrative. Fillimi i procedurave për dhënien e masave disiplinore dhe administrative. Sa rekomandime janë pranuar dhe ecuria e tyre për masat e dhëna.

Nga verifikimi i korrespondencës me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK rezultoi se nuk është marrë asnjë masë disiplinore për punonjësit të konstatuar si përgjegjës për shkeljet e konstatuara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

IV.KONKLUZIONI I AUDITIMIT

Mbështetur në standardet e INTOSAI-t, Manualit të Përputhshmërisë, Manualit të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, nga auditimi tematik i kryer në DVASHK Sarandë, rezultoi se niveli i zbatimit të rekomandimeve plotësisht, pjesërisht ose në proces zbatimi, është në nivelin 20%. Nga rekomandimet e lëna në auditimin e mëparshëm janë pranuar 25 plotësisht, ku për përmirësimin e gjendjes janë lënë 46 masa organizative, 5 masa për të ardhura të munguara, 1 shpërblim dëmi në vlerën 5,436,194 lekë dhe 14 masa disiplinore, nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna”.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

Për përmirësimin e gjendjes nga 46 masa organizative të lëna rekomandim nga KLSH, janë zbatuar plotësisht 3 rekomandime, zbatuar pjesërisht 4 rekomandime, janë në proces zbatimi 6 rekomandime dhe janë pazbatuar 17 rekomandime. Pjesa tjetër e rekomandimeve janë ezauruar për arsye të ndryshimeve ligjore ose shkaqe të tjera të argumentuara në këtë akt-konstatim.

Për të ardhura të munguara janë lënë 5 rekomandime në vlerën 958,213,325 lekë (pranuar 4 dhe papranuar 1, zbatuar pjesërisht 3, plotësisht 1 dhe pazbatuar 1), nga të cilat janë arkëtuar 56,782,786 lekë, si dhe është lënë 1 rekomandim për shpërblim dëmi në vlerën 5,436,194 lekë i cili nuk është pranuar dhe nuk është zbatuar.

Janë lënë 14 masa disiplinore nga të cilat nuk është zbatuar asnjë prej tyre nga Drejtoria e Përgjithshme të ASHK.

V. Gjetje dhe Rekomandime:

Për përmirësimin e punës në të ardhmen, rekomandojmë:

A. MASA ORGANIZATIVE

Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së me shkresën përcjellëse nr. 902/8 prot., datë 22.05.2020, nuk janë zbatuar rekomandimet si vijon:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI TEMATIK “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA” NË
DVASHK SARANDË

-Rekomandim nr.1.1: Drejtoria Vendore e ASHK Sarandë, për nevoja të plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor të objekteve me leje legalizimit të lëshuara, t’i kërkojë Bashkive Sarandë, Himarë, Finiq dhe Konispol, vërtetimet mbi llogaritjen dhe pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën prej 804,249,039 lekë, si dhe të kërkojë që të bëhet regjistrimi në sektorin përkatës të kartelës në Drejtorinë Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Sarandë, në refuzim të vendosën masë për kufizimin deri në arkëtimin e plotë të detyrimeve të papaguara.

Rekomandim nr.5.1: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Sarandë:

1. Në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK Tiranë, për objektet informale të pajisura me leje legalizimi në rastet si më lart në kundërshtim, me dispozitat e ligjit dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, dhe të fillojë procedurat për shfuqizimin e lejes së legalizimit.

2. Për pasuritë e regjistruar sipas lejeve legalizimi konstatuar të lëshuara me shkelje në raste e mësipërme të marrë masa në bazë të nenit 27 pika 1 e 4 të ligjit 111, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën” të nxjerrë urdhër kufizimi deri në plotësimin e dokumentacionit të kërkuar ligjor.

-Të marrë masa dhe të vendoset masë kufizimi për këto pasuri deri në rikthimin e ligjshmërisë për këto pasuri.

Rekomandim nr.6.1: Nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Sarandë, të marrën masa për plotësimin e dosjes me dokumentacionin e kërkuar ligjor për objektin informalë të pajisur me leje legalizimi si më lart.

Rekomandim nr.8.1: Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Sarandë bazuar në nenin 27, pika 1 e 4, të ligjit nr.111, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, të kërkojë nga subjekti plotësimin e dosjes së lejes së legalizimit me akt-ekspertizës për qëndrueshmërinë e objekti, në të kundërt në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK Tiranë, të fillojë procedurat për shfuqizimin e lejes së legalizimit duke nxjerrë urdhër kufizimi deri në plotësimin e dokumentacionit të kërkuar ligjor.

Rekomandim nr.10.1: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Sarandë të marrë masa dhe të rivlerësojë gjendjen juridike të pronave për subjektet sipas referencave nr.2968 ; nr.02555 ; nr.02554 ; nr.02557 , nr.02564 , nr.02566 , nr.02596 , nr.02586 , nr.02578 , nr.02567 , nr.02761 , nr.02747 , nr.02749 , nr.02699 , nr.02714 , nr.02710 , nr.02704 , nr.2833 , nr.02553, nr.02562 , nr.02609 , nr.02709, nr.2746, nr.2647, nr.02674, nr.02682 , nr.02651, nr.02659, nr.02660 dhe të veprojë me përgjegjësi duke rikthyer ligjshmërinë e tyre.

Rekomandim nr.10.2: Për të ardhmen të mos kryhen regjistrime si akte administrative, (përfshirë leje legalizimi) për objektet informale, në kushtet e mosrespektimit të PPV të miratuar dhe të Zonës së Mbrojtur të miratuar me akte ligjore e nënligjore.

Rekomandim nr.11.1: Drejtoria Vendore të ASHK Sarandë të marrë masa, bazuar në nenin 27, të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, duke vendosur kufizimin për pasuritë e regjistruar sipas referencave nr.1713; nr.1699; nr.1700; nr.1702; nr.1703; nr.1689; nr.1626; nr.2006; nr.2055; nr.01595; nr.01594; nr.01571; nr.01601; nr.01600; nr.1580, deri në shqyrtimin dhe rivlerësimin edhe një herë nga sektori i legalizimit, të dokumentacionit tekniko ligjor, mbi bazën e të cilit janë lëshuar 15 lejet e legalizimit, duke njoftuar subjektet për fillimin e procedurave përkatëse sipas kërkesave të ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”.

Rekomandim nr.27.1: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Sarandë, të marrë masë për plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor dhe evidentimin e pagesës mbi shlyerjen e detyrimeve pranë Bashkisë Sarandë.

Rekomandim nr.28.1: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë të marrë masa, që në zbatim të nenit 27, të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, të vendosë masë kufizimi, deri në plotësimin e dokumentacionit ligjor si dhe Preventivin sipas lejes së ndërtimit dhe situacioni përfundimtar, për të llogaritur diferencën e taksës së infrastrukturës nga ajo e paguar në Bashki dhe rikthimin e ligjshmërisë.

Rekomandim nr.29.1: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë të marrë masa, që në zbatim të nenit 27, të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, të vendosë masë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI TEMATIK “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA” NË
DVASHK SARANDË

kufizimi deri në plotësimin e dokumentacionit ligjor, si Lejen e ndërtimi për ndërtim të përkohshëm si dhe Praktikës të bashkëngjitet Akti i vlerësimit dhe procesverbali të piketimit të truallit dhe rikthimin e ligjshmërisë.

Rekomandim nr.30.1: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë të marrë masa, që në zbatim të nenit 27, të ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, të vendosë masë kufizimi për pasuritë e trajtuara në gjetjen nr.30.

Rekomandim nr.34.1: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë të marrë masa, që në zbatim të nenit 27, të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, të vendosë masë kufizimi të vendosë masë kufizimi deri në plotësimin e dokumentacionit ligjor të kërkuar dhe rikthimin e ligjshmërisë, duke njoftuar subjektin B. K. për vendosjen e masë kufizimit dhe pas kalimit të afatit ligjor 30 ditor të kryejë regjistrimin e pronës në favor të qytetarit K. Th. K.

Rekomandim nr.35.1: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë të marrë masa, që në zbatim të nenit 27, të ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, të vendosë masë kufizimi për pasurinë e regjistruar sipas referencës nr.18018, ZK 8641, deri në plotësimin e dokumentacionit ligjor të kërkuar dhe rikthimin e ligjshmërisë.

Rekomandim nr.38.1: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë, në zbatim të nenit 27, të Ligjit nr.111, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën” të marrë masa për vendosjen e masës së kufizimit për:

- pasuritë nr.14/168 vol 22 fq 174 me qëllim kryerjen e veprimeve korrigjuese nga nocioni I në nocionin F, certifikatës familjare;

- pasurinë nr.14/169 vol 22 fq 175, për diferencën në sipërfaqen e llojit “Truall” në masën 10 m²; kufizim për pasurinë 3/347/nd në volumn nr.22 fq 22, me qëllim kryerjen e veprimeve përkatëse në seksionin B (përfshirjen e truallit në KPP), regjistrimin e kësaj pasurie me nocionin F, referuar certifikatës familjare, si dhe vendosjen e hipotekës ligjore në favor të DVASHK Sarandë në seksionin E për parcelën ndërtimore që do të miratohet me VKM;

- pasurinë nr.14/169 vol 22 fq 184 me sipërfaqe 462 m² në pronësi shtet, në pasurinë nr.14/170 vol 22 fq 185 me sipërfaqe 73 m² në pronësi shtet, në pasurinë nr.14/172 vol 22 fq 187 me sipërfaqe 135 m² në pronësi shtet, si dhe në pasurinë nr.14/173 vol 22 fq 188 me sipërfaqe 448 m² në pronësi të P. B., me qëllim kryerjen e veprimeve përkatëse për sistemimin e diferencës së sipërfaqes prej 74 m², si dhe regjistrimin e pasurisë së legalizuar me lejen e legalizimit nr.62415 me nocionin F, referuar certifikatës familjare deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor të kërkuar dhe rikthimin e ligjshmërisë.

Rekomandim nr.40.1: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë, të marrë masa: për evidentimin e 1252 praktikave në proces, kohëzgjatjen nga aplikimi, evidentimin e problematikave, krijimin e mbajtjes së evidencës së praktikave në proces, si dhe të marrë masa për inventarizimin e dokumentacionit për 1252 praktikat në proces e të pa përfunduara.

Rekomandim nr.41.1: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë të marrë masa, për regjistrimin hipotekor të lejes së legalizimit nr. 45569, datë 21.05. 2013, në përputhje e zbatim të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, si dhe nenit 53 të ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”.

Rekomandim nr.45.1: Nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Sarandë të merren masa: Për zbatimin e Vendimit të Gjykatës së Lartë nr. 152, datë 16.03.2019 “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr. 20-2018-30/16 datë 16.01.2018 i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë”, për heqjen e sekuestrove konservative të vendosura sipas kërkesës me nr.1349 prot datë 16.02.2018 nga Zyra Përmbartimore “B.-K”; Si dhe për vazhdimin regjistrimi i pasurive që rrjedhin nga pasuria nr. 18/77 nd, në përputhje e zbatim të dokumentacionit ligjor të paraqitur për regjistrim dhe rikthimin e ligjshmërisë.

Rekomandim nr.46.1: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Sarandë të marrë masa që në bashkëpunim me Bashkinë Sarandë të kërkojë në mënyrë zyrtare (me shkresë) për përcaktimin e saktë të gjurmës së objektit (të legalizuar e shkualifikuar) me lejen nr. 1042826,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI TEMATIK “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA” NË
DVASHK SARANDË

datë 31.07.2019 “Godinë me funksion social-ekonomik me 2 kate”, dhe saktësimin e statusit tekniko juridik në lidhje me zonën C.2. Bredenesh Sarandë për të përcaktuar cënimin ose jo të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Sarandë miratuar Vendimin e KKT nr. 3, datë 16.10.2017. Me marrjen e shkresës të procedojë me rikthimin e ligjshmërisë të kësaj leje legalizimi (*Më hollësisht trajtuar në faqe 13-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Sarandë, për rastet e evidentuara më sipër, të marrë masa për zbatimin e rekomandimeve.

Deri më datë 31.08.2021

B. MASA SHPËRBLIM DËMI EKONOMIK

Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së me shkresën përcjellëse nr. 902/8 prot., datë 22.05.2020, nuk janë zbatuar rekomandimet si vijon:

Rekomandim nr.1.1: Nga Titullari i DVASHK Sarandë të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës 5,436,194 lekë, të ardhura të munguara me efekt dëm ekonomik, të krijuara nga mos llogaritjet e sakta të tatimit dhe taksës së kalimit të të drejtave mbi pronën (*Më hollësisht trajtuar në faqe 25-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Sarandë, të marrë masat e nevojshme për të ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës 5,436,194 lekë.

Deri më datë 31.08.2021

C. MASA TË ARDHURA TË MUNGUARA

Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së me shkresën përcjellëse nr. 902/8 prot., datë 22.05.2020, nuk janë zbatuar rekomandimet si vijon:

Rekomandim nr.4.1: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë të marrë masa, që në zbatim të nenit 27, të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, të vendosë masë kufizimi deri në administrimin e dokumentacionit të pagesës së diferencës së truallit në vlef të prej 3,543,126 leke dhe të ndjekë në rrugë ligjore arkëtimin e taksës së kalimit të pronësisë në shumën 531,469 lekë.

Rekomandim nr.5.1: Drejtoria Vendore e ASHK Sarandë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore deri në daljen e VKM-ve, për 16 dosje të objekteve informale të pajisur me Leje legalizimi të objektit, për të mundësuar brenda afateve ligjore likuidimin të vlef të parcelave ndërtimore prej 19,158,879 lekë, si e ardhur e munguar për Buxhetin e shtetit dhe fondin e kompensimit të ish-pronarëve (*Më hollësisht trajtuar në faqe 26-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Sarandë, të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore në favor të përfituesve të lejeve të legalizimit, për të mundësuar likuidimin e vlerës së parcelave ndërtimore në vlerën 19,158,879 lekë.

Deri më datë 31.08.2021

VI. LISTA E DOKUMENTAVE TË AUDITIMIT

1.Akt-konstatimi nr.1, datë 26.02.2021, mbajtur në DVASHK Sarandë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI TEMATIK “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA” NË
DVASHK SARANDË

Shënim: Pas hartimit të Projektraportit të auditimit mbi bazën e dokumentave të mësipërme dhe përcjelljes së tij, nga subjekti i audituar nuk janë paraqitur observacione, prandaj bazuar sa sipër hartohet Raporti Përfundimtar i Auditimit.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT